



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 1675/prot.

Tiranë, më 18.05.2020

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1780, datë 12.11.2015.

SHOQËRISË “GERDA - 07” SH.P.K

Lagjia e Re, Blloku 4, Shkalla 3, Ap.8, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “GERDA - 07” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1780, datë 12.11.2015, për mineral krom, në objektin “Zalli i Luçanës”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.1241, datë 11.02.2020, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.1675, datë 13.02.2020, është propozuar revokimi i lejes shfrytëzimit nr.1780, datë 12.11.2015, për mineral krom, në objektin “Zalli i Luçanës”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, sepse nuk keni paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2019, duke mos respektuar kërkesat e nenit 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në germën “c” e germën “ç” të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1780, datë 12.11.2015, për mineral krom, në objektin “Zalli i Luçanës”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të nr.1780, datë 12.11.2015, për mineral krom, në objektin “Zalli i Luçanës”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër”.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

